



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

VENDIM

Nr. 4318 prot

Balsh më 2003 / 2026

Nr. 08 datë 20 / 08 / 2026

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB Nr.12 datë 24.02.2020, Neni 22, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 20 / 08 / 2026:

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 28 / 08 / 2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyr në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(Klodjan Shehaj)

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit

(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

(Maxhmi Selaj)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 4318 / prot. 1

Ballsh më 2008 .2026

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e Premte, **datë 28.08.2026, ora 10:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Proces-verbalit të mbledhjes më datë 22.07.2026.
3. **Projektvendim Nr.41:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.

4. **Projektvendim Nr.42:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare z. Ramadan Mecaj, banorë i fshatit Riban, Njësia Administrative Ngracan, Bashkia Mallakastër, banesa 1 (një) katëshe e të cilit është dëmtuar si pasojë e një zjarri të rënë më datë 07.07.2026

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Ekonomik dhe Emergjencat.

5. **Projektvendim Nr. 43:** Për miratimin e marrëveshjes së investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Në theks të zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare (FAZA II) impiant fotovoltaiik me fuqi 123.72 KWP në godinën dhe parkimin e Bashkisë Mallakastër, dhe impiant fotovoltaiik 286.125 KWP në gjimnazin “Dervish Hekali “Ballsh, Bashkia Mallakastër

Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik

6. **Projektvendim Nr.44** : Për miratimin e marrëveshjes së investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Ndërhyrjen për përmirësimin e shtresave asfaltike (FAZA IV) LOT 2 në rrugën Aranitas -Gjerbës , Bashkia Mallakastër dhe miratimin në parim për shpronësimin / zhdëmtimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik
7. **Projektvendim Nr.45**:Për miratimin e projektit me objekt : “ Rikonstruksioni i rrugëve në qytetin Ballsh”, Bashkia Mallakastër.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik
8. **Projektvendim Nr.46**: Për miratimin e projektit me objekt : “ Rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Qendër”, Bashkia Mallakastër
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik
9. **Projektvendim Nr.47**: Për miratimin e projektit me objekt : “Rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Fratar”, Bashkia Mallakastër
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik
10. **Projektvendim Nr.48**: Për miratimin e projektit me objekt :”Rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Selitë”, Bashkia Mallakastër
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik
11. **Projektvendim Nr.49**: Për miratimin e projektit me objekt : “Rikonstruksioni i rrugëve në Njësinë Administrative Kutë” , Bashkia Mallakastër
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.
12. **Projektvendim Nr.50**: Për një plotësim të vendimit me nr. 39,datë 22.07.2026 “ Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Mallakastër 2026-2031”.
Komisioni për shqyrtim: Komisioni Juridik.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

